REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT
MINISTRIA E FINANCAVE-MINISTARSTVO ZA FINANSIJE-MINISTRY OF FINANCE
Njësia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit: 02/KOM/MAPL  Nr. Prot / Br. Prot. / Prot. No: 691-1/2026
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages:  Data / Datum / Date: 24.04.26
PRISHTINË/ PRIŠTINA / PRISHTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***
*Ministria e Financave - Ministarstvo Finansija- Ministry of Finance*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Gazmend Muhaxheri**, Kryetar i Komunës së Pejës<br><br>**Rexhep Kurtbogaj**, Kryesues i Kuvendit të Komunës | |
| Kopje: | **Elbert Krasniqi,** Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>**Jeton Qela,** Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | |
| Përmes: | **Hekuran Murati**, Ministër në Ministrinë e Financave<br><br>**Arton Ahmeti,** Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave | |
| Nga: | **Bora Duli,** Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave | Datë:<br>15.04.2026 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor<br><br>2.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor | **Medina Millaku,** Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave<br><br>**Kimete Zekaj**, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave | Referencë:<br>47/2026 |
| Lënda: | Konfirmim i Ligjshmërisë | |
| Lloji i aktit: | **Vendim** | |

I nderuari Kryetar z. Muhaxheri,
I nderuar Kryesues z. Kurtbogaj

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

| |
|---|
| ***Vendimi Nr. 22/2026 për bartjen e mjeteve te pa shpenzuara buxhetore nga viti 2025 ne vitin 2026.*** |
| ***I miratuar më datë 31.03.2026*** |
| ***I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 02.04.2026*** |
| ***I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave më datë 02.04.2026*** |

Ministria e Financave (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Pejës, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Pejës, me anë të aktit administrativ komunal synon miratimin e Vendimit për bartjen e mjeteve te pa shpenzuara buxhetore nga viti 2025 ne vitin 2026.

2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se proceset e mësipërme evidentohen edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë se Financave, Punës dhe Transfereve, por duke mos u kufizuar ne dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "**LMFPP**") dhe Ligjit 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.

3. Kështu, në kuptim të ndarjeve buxhetore komunale, neni 8, paragrafit 6 dhe 7 i Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2026, përcakton se në rast se shuma e të hyrave vetanake të Komunës gjatë vitit i kalojnë shumat e të hyrave të ndara të asaj komune ato mjete barten në vitin 2026, si në vijim:

*Neni 8*

*Ndarja dhe ri-ndarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak*

*6. Bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore*

*për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2026 sipas vendimit të Kuvendit Komunal dhe autorizimeve të LMFPP-së.*

*7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2025 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për vitin 2025, barten në vitin 2026 në përputhje me vendimin e Kuvendit Komunal. Prioritet duhet të ketë ndarja e mjeteve për mbulimin e detyrimeve ekzistuese kontraktuale apo detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.*

4. Po ashtu, sipas nenit 27 të Ligjit 03-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ndarjet buxhetore që ndërlidhen me të hyrat vetanake të pashpenzuara të komunës do të vazhdojnë për komunën përkatëse në vitin e ardhshëm fiskal, si në vijim:

***Neni 27***

***Skadimi i ndarjeve buxhetore në fund të viti fiskal***

*Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërlidhen me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të komunave, apo të ndonjë organizate tjetër buxhetore të cilës i janë lejuar me ligj, e të cilat barten në vitin vijues.*

5. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata ka bërë ndryshimin e planit të buxhetit për vitin 2026 dhe ka bërë bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2025. Përkundër kësaj, realizimi i suksesshëm i një procesi të tillë karakterizohet me detaje teknike buxhetore për të cilat organizatat buxhetore bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Buxhetit.

6. Ne këtë kuptim, Ministria konstaton se ligjërisht, Komunave ju mundësohet që këto bilance të përdoren për të financuar edhe projekte të reja dhe ekzistuese në vitin aktual, mirëpo realizimi i suksesshëm i tyre kushtëzohet me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.

7. **Rrjedhimisht, akti administrativ i Komunës së Pejës është në përputhje me legjislacionin në fuqi - me kusht që Komuna të bashkëpunojë ngushtë dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe/apo rekomandimeve të Departamentit të Buxhetit.**

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Pejës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.
Me respekt!

***Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave***

# Republika e Kosovës
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave | |
| Kopje: | Kryetari i Komunës së Pejës<br>Kryesuesi i KK – Pejë<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor | Data:02.04.2026<br>VI- 020-253 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës<br>2.Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit<br>Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve Komunale | |
| Lënda: | Shkresë përcjellëse në MF | |
| Lloji i aktit: | **Vendim** | |

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: Vendimin Nr. 22/2026 për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore nga viti 2025 në vitin 2026, i miratuar në Kuvendin e Komunës së Pejës dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Pejës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe në nenet 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

**Vendimin Nr. 22/2026 për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore nga viti 2025 në vitin 2026**

**I miratuar më datë: 31.03.2026**
**I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.04.2026**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË
I.Numër: 016/01-19052, datë: 31 Mars 2026.

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 1 dhe 2 nënpika d), dhe nenit 24, të Ligjit Nr. 03/L - 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L - 049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me ligjin Nr. 05/L-007, neni 8, paragrafi 6 dhe 7 i Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-113431, dt. 30 Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31 Mars 2026, në propozim të Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe kryetarit të Komunës, merr:

## VENDIM
## Nr. 22/2026
Për bartjen e mjeteve të pashpenzuara buxhetore nga viti 2025, në vitin 2026

I. MIRATOHET bartja e mjeteve në shumë prej 3,874,021,66 €, si në vijim:

- Mallra dhe shërbime në shumën prej 233,388.00€
- Shpenzime kapitale në shumën prej 3,640,633.66€

I.1. <u>Në kategorinë mallra dhe shërbime:</u>
Administrata (16319) shuma prej 30,000.00
- Planifikimi Urban dhe Mjedisi (66100) shuma prej 15,000.00€
- Kulturë, rini dhe sport (85019) shuma prej 100,000.00€

Arsimi Parafillor (92570) shuma prej 88,388.00€

I.2. <u>Në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në nën programet</u>
Administrata (16319) në projekte:

- "Ndërtimi I objektit të administratës në Vitomerice" kodi 54938 në shumë prej 41,000.€
- "Ndërtimi I objektit të Administratës në hapësirat e ish Urbanizmit (Arsim, Urbanizëm, Shërbime Publike, Kultur)" kodi 55800 në shumë prej 290,000.€

<u>Infrastruktura Rrugore (18019) ne projektet:</u>

- " Ujësjellësi për lshatrat e Lugut të Baranit" kodi 85946 në shumë prej 73,345,21€
- " Ndertimi I Sheshit Hotel Korze - Ura e zallit" kodi 54629 në shumë prej 92,941.95€
- "Ndërtimi I Urës së automjeteve Kapeshnicë – Qendër" kodi 54635 ne shumë prej 20,290.08€
- " Ndërtimi dhe rregullimi I hapësirave gjelbruese buzë Lumbardhit dhe në lagjen Asllan Çeshme." kodi 54657 ne në shumë prej 95,000.€

- " Ndërtimi i trafos në Qardhe dhe shkollen fillore në Vitomericë" kodi 20840 në shumë prej 58,558.00€
- " Blerja e pajisjeve gjeodezike" kodi i projektit 55255 në shumë prej 24,000.000
- "Ndërtimi i shtëpisë së fshatit në Nabërgjan dhe Radac (Lagja Avdyla)" kodi 20750 në shumë prej 60,000.00€
- " Ndërtimi i rrugës në zonën industriale në Zahaq, Sferk dhe Lutogllav" kodi 55989 në shumë prej 200,000.00€
- " Ndërt. i kanalizimeve në Raushiq, Kryshec, Brolic, Trestenik, Baran, Ujëmirë, Nepole, Nabergjan, Katund i Ri " kodi 53813 në shumë prej 50,000.00€
- " Asfaltimi i Rrugës Sejnove – Gjore" kodi 54632 në shumë prej 133,188.88€
- "Rindërtimi i Murit të lumit dhe ngritja e murit me gurë" kodi 54655 në shumë prej 42,010.00€
- " Ndërtimi i impiantit në Jubilancë të Leshanit" kodi 54664 në shumë prej 400,000.00€
- "Ndërtimi i kanalit në lagjen Asllan Çeshme" kodi 54662 ne shumë prej 95,000.00€
- "Ndërtimi i shesheit prej Ures së Zallit deri te Ura e re (Haxhi Zeka)" kodi 55005 në shumë prej 200,000.00€
- "Ndërtimi i rrugëve në Rekë të Allagës -Pecaj, Varri Sylai Lloz-Bellopaq, Shtupeq i Madh - Qafa e Drogit, Dukaive, Kuçishte, Koshutan, Boge-Shkrel, Pudi Juka" kodi 54650 ne shumë prej 514,999.€
- "Ndërtimi i rrugëve në Kamenice, Dubiq, Pishtan, Millovanc, Paqesë dhe Vragoc" kodi 52672 ne shumë prej 15,001.00
- "Ndërtimi i rrugës Qendra "Pëllumbat e Paqes"-Shetitorja buz Lumbardhit" kodi 56163 në shumë prej 56,000.00€
- "Ndërtimi i mureve mbrojtëse nga rrëshqitja e dheut në lagjen Kapeshnicë dhe Durahni "projekt i ri në shumë prej 114,300.42€
- "Rregullimi i kanalizimit në Vitomerice, Kristal, Qyshk, Duradun, Raushiq " projekt i ri në shumë prej 100,000.00€
- "Ndriçimi në Vitomericë, Fshatrat e Podgurit, Lagjet të Trestenikut, Lagjet të Leshanit, Lagjet të Baranit dhe lagjet e qytetit " projekt i ri në shumë prej 100,000.€
- "Blerja e autofshisave me furça rrotulluse për fshirjen e rrugëve në qytet" projekt i ri shumë prej 160,000.00 €

<u>Bujqësi (47019) ne projekt</u>

- " Ndërtimi kanaleve të ujitjes në regjionin e lugut të Baranit,Trestenikut, Leshanit, Podgurit dhe Fusha e Pejes" kodi i projektit 54572 ne shumë prej 150,000.00€

<u>Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik (48019)</u> në projekt:

- "Ndërtimi i Muzeut të Bjeshkëve afër Kishës katolike" kodi i projektit 54620 në shumë prej 30,000.00€

<u>Shërbimet e shëndetësisë primare (74100) ne projekt:</u>

- " Furnizim me pajisje dhe inventar për funksionalizimin e QMF në fsh. Trestenik" projekt i ri në shumë prej 40,000.00€

**Shërbimet Rezidenciale ( 75592) në projekt:**

- " Blerja e inventarit për shtepinë e qendrimit të përkohshëm" projekt i ri në shumë prej 40,000.00€

<u>Shërbimet Kulturore (85019) ne projekt:</u>

- "Ndërtimi i fushës së pestë të tenisit në fsh. Brestovik" projekt i ri në shumë prej 100,000.00€

Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93500) në projektet:

- "Rindërtimi i Shkollave dhe Aneksave në Nabergjan, Llozhan, Tërstenik, Lidhja e Prizrenit, Ramiz Sadiku, Qyshk, Zahaq, Nabergjan dhe rrethoja në HII Mosi Jablanica" me kod projekti 54670 në shumë prej 100,000.€
- "Blerja e kombibusëve për shkolla " kodi i projektit 56145 në shumë prej 135,000.00€
- "Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Llozhan" kodi i projektit 20776 në shumë prej 150,000.00€

<u>Arsyetim për Mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere:</u>

Në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime do të plotësohet mungesa e mjeteve në vlerë prej 238,188.00€, për shkak të buxhetit jo të mjaftueshëm për pagesën e obligimeve për shërbimet e mirëmbajtjes së objekteve arsimore dhe angazhimin e stafit me shërbime të veçanta në drejtorinë e kulturës, stafit edukativo sportiv, dhe të urbanizimit për punimin e hartave zonale.

<u>Arsyetim për obligimet kontraktuale</u>

Mjetet janë bartur me qëllim të mbulimit të obligimeve të projekteve të cilat janë në realizim e sipër, mungesa është si pasojë e shpenzimit të një pjese të mjeteve për vendimet gjyqësore, realizimin e disa projekteve të reja me prioritet dhe mbulimin e mungesës së mjeteve të projekteve në kornizën afatmesme buxhetore.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa të Komunës së Pejës.

4. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

KRYESUESI I KUVENDIT,

Roxhaj Kurtbogaj

Vendimi t'i dërgohet:
MAPL dhe MFPT,
Kryetarit të Komunës,
DBF - së
Arkivës.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS  MUNICIPALITY OF PEJA  OPŠTINA PEĆ

02.04.2026
01-[illegible]

**SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ**
Br. 1: 016/01-49052, datum 31. mart 2026.godine

Na osnovu člana 11, člana 12 stav 1 i 2 tačka d), i člana 24 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi Republike Kosova, Zakona br. 03/L-049 o finansijama lokalne vlasti, Zakona br. 03/L-048 o upravljanju javnim finansijama i odgovornostima, dopunjenog i izmenjenog Zakonom br. 03/L-221, Zakonom br. 04/L-116, Zakonom br. 04/L-194, Zakonom br. 05/L-063, Zakonom br. 05/L-007, člana 8 stav 6 i 7 Zakona br. 10/L-001 o budžetskim raspodelama za budžet Republike Kosova za 2026. godinu i člana 20 stav 1 tačka 1.d Statuta br. 01/2020 Opštine Peć, br. 1: 01-016/01-41343, od 30. septembra 2020, Skupština opštine Peć, na sednici održanoj dana 31. marta 2026. godine, na predlog Direktorata za budžet i finansije i Gradonačelnika opštine, donosi:

**ODLUKU**
**Br. 22/2026**
**O prenosu neiskorišćenih budžetskih sredstava iz 2025. u 2026. Godinu**

1. USVAJA SE prenos sredstava u iznosu od 3,874.021,66 €, kako sledi:

- Roba i usluge u iznosu od 233.388,00 €
- Kapitalni rashodi u iznosu od 3.640.633,66 €

1.1. <u>U kategoriji roba i usluge:</u>

- Administracija (16319) u iznosu od 30.000,00 €
- Urbanističko planiranje i životna sredina (66100) u iznosu od 15.000,00 €
- Kultura, omladina i sport (85019) u iznosu od 100.000,00 €

Predškolsko obrazovanje (92570) u iznosu od 88.388,00 €

1.2. <u>U kategoriji kapitalnih rashoda, u podprograme:</u>

Administracija (16319), u projekte:

- „Izgradnja objekta administracije u Vitomirici", kod 54938, u iznosu od 41.000 €
- „Izgradnja objekta administracije u prostorijama bivšeg Urbanizma (obrazovanje, urbanizam, javne usluge, kultura)", kod 55800, u iznosu od 290.000 €

<u>Putna infrastruktura (18019) u projekte:</u>

- „Vodovod za sela Baranski Lug", kod 85946, u iznosu od 73.345,21 €
- „Izgradnja trga Hotel Korzo – Peščani Most", kod 54629, u iznosu od 92.941,95 €
- „Izgradnja mosta za motorna vozila Kupušnica - Centar", kod 54635, u iznosu od 20.290,08 €

• „Izgradnja i uređenje zelenih površina uz Bistricu i u naselju Asllan Českun", kod 54657, u iznosu od 95.000 €

• „Izgradnja trafostanice u obdaništu i osnovne škole u Vitomirici", kod 20840, u iznosu od 58.558,00 €
• „Kupovina geodetske opreme", kod projekta 55255, u iznosu od 24.000,00 €
• „Izgradnja seoskog doma u Nabrđu i Radavcu (naselje Avdyla)", kod 20750, u iznosu od 60.000,00 €
• „Izgradnja puta u industrijskoj zoni u Zahaču, Škrelu i Ljutoglavi", kod 55980, u iznosu od 300.000,00 €
• „Izgradnja postrojenja u Rašiću, Kruševu, Brolić, Tristenik, Durnac, Glođane, Nepolje, Nabrđe, Pećkom Selu ", kod 53813, u iznosu od 50.000,00 €
• „Asfaltiranje puta Sejnovce – Gjoro", kod 54632, u iznosu od 113.180,00 €
• „Rekonstrukcija potpornog zida i oblaganje zida kamenom", kod 54655, u iznosu od 42.010,00 €
• „Izgradnja postrojenja u Lješanskoj Jablanici ", kod 54664, u iznosu od 400.000,00 €
• „Izgradnja kanala u naselju Asllan Českun", kod 54662, u iznosu od 95.000,00 €
• „Izgradnja trga od Pešćanog mosta Zalli do novog mosta (Hajdaraga)", kod 55905, u iznosu od 200.000,00 €
• „Izgradnja puteva u Alaginoj Reci – Pecaj, Vari Sykut Lugu – Belopać, Veliki Štupelj – Provoj Drnoli, Dukaivo, Kućište, Košutane, Boge-Skrelj, Jakupov Pod ", kod 54656, u iznosu od 514.999 €
• „Izgradnja puteva u Kamenici, Babiću, Plešini, Milovancu, Počešću i Vragocu ", kod 52672, u iznosu od 15.001,00 €
• „Izgradnja puta kod obdaništa "Pëllumbat e Paqes" – Šetalište uz Bistricu", kod 56163, u iznosu od 56.000,00 €
• „Izgradnja zaštitnih zidova od klizišta u naseljima Kapešnica i Dardanija" – novi projekat, u iznosu od 114.300,42 €
• „Uređenje kanalizacije u Vitomirici, Kristal, Ćuški, Dardaniji, Raušiću" – novi projekat, u iznosu od 100.000,00 €
• „Rasveta u Vitomirici, selima Podgurija, Lugu Trestenik, Lješanskom Lugu, Baranskom Lugu i gradskim naseljima" – novi projekat, u iznosu od 100.000 €
• „Kupovina vozila sa rotacionim četkama za čišćenje ulica u gradu" – novi projekat, u iznosu od 160.000,00 €

<u>Poljoprivreda (47019) u projekat</u>
„Izgradnja kanala za navodnjavanje u regionu Baranskog Luga, Trestenika, Lješana, Podgurija i Pećkog Polja", kod projekta 54572, u iznosu od 150.000 €

<u>Planiranje i ekonomski razvoj (48019) u projekat:</u>
„Izgradnja Muzeja planinarstva pored katoličke crkve", kod projekta 54620, u iznosu od 30.000 €

<u>Primarna zdravstvena zaštita (74100) u projekat:</u>
Nabavka opreme i inventara za funkcionisanje Doma zdravlja u selu Trestenik" – novi projekat, u iznosu od 40.000 €

Rezidencijalne usluge (75592) u projekat:
" Kupovina inventara za kuću za privremeni boravak"– novi projekat, u iznosu od 40.000 €

<u>Kulturne usluge (85019) u projektu:</u>

- „Izgradnja pelog teniskog terena u selu Brestovik" – novi projekat, u iznosu od 100.000 €

Osnovno i niža srednje obrazovanje (93540) u projektu:

„Rekonstrukcija škola i aneksa u Nabrđnu, Lozhanu, Trstenik, Lidhja e Prizrenit, Ramiz Sadiku, Čuški, Zahaću, Nabrđanu i Hil Mosi Jablanici", kod projekta 74670, u iznosu od 100.000 €

- „Kupovina školskih kombija", kod projekta 56145, u iznosu od 135.000 €
- „Izgradnja osnovne škole u selu Llozhan", kod projekta 20776, u iznosu od 150.000 €

<u>Obrazloženje za robu i usluge, subvencije i transfere:</u>

U kategoriji rashoda za robu i usluge popuniće se manjak sredstava u iznosu od 298.380,00 €, zbog nedovoljnih budžetskih sredstava za plaćanje obaveza za održavanje obrazovnih objekata i angažovanje osoblja na posebnim uslugama u Direktoratu za kulturu, obrazovno-sportskom osoblju i u urbanizmu za izradu zonalnih mapa.

<u>Obrazloženje za ugovorne obaveze:</u>
Sredstva su preneta sa ciljem pokrića obaveza za projekte koji su u toku realizacije; manjak je nastao kao posledica trošenja dela sredstava za sudske odluke, realizaciju nekoliko novih projekata sa prioritetom i pokriće manjka sredstava za projekte u okviru srednjoročnog budžetskog okvira.

2. Za sprovođenje ove Odluke biće zadužen predsednik opštine u saradnji sa Direktorom za budžet i finansije Opštine Peć.

3. Ova odluka se objavljuje trideset (30) dana nakon registracije u Kancelariji protokola Ministarstva za Administraciju Lokalne Vlasti i stupa na snagu sedam (7) dana nakon objavljivanja na zvaničnom jeziku na web stranici Opštine Peć.

PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE,
Rexhep Kurtbogaj

Odluka se dostavlja:
MALV-u i MERT,
Gradonačelniku Opštine,
DBF-u
Arhivi,